

20191802778

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM PENSIONAL DHE
INVALIDOR

Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18 dhe 245/18), pas nenit 91-b shtohet titull i ri dhe nen i ri 91-v, si në vijim:

“Të siguruarit nga Agjencia për Siguri Nacionale

Neni 91-v

(1) Të punësuarit me detyrime të veçanta dhe autorizime në Agjencinë për Siguri Nacionale, stazhi i sigurimit i llogaritet me kohëzgjatje të zmadhuar edhe atë çdo 12 muaj të kaluara në mënyrë efektive në ato detyrime dhe autorizime llogariten si 16 muaj stazh i sigurimit.

(2) I punësuar nga paragrafi (1) i këtij neni i cili ka së paku 25 vjet stazh pensional prej të cilave 15 vjet të kaluara në mënyrë efektive në vende pune për të cilat stazhi i sigurimit llogaritet me kohëzgjatje të rritur dhe 55 vjet (mashkull), përkatësisht 50 vjet (femër), mund të realizojë të drejtën e pensionit sipas pleqërisë, nëse marrëdhënia e punës i ndërpritet sipas nevojës së shërbimit.”.

Neni 2

Në nenin 118 paragrafi (3) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: “nëse kanë stazh të mbushur të sigurimit me kohëzgjatje të zmadhuar i cili mundëson zvogëlimin e kufirit të moshës për realizimin e të drejtës për pension sipas pleqërisë për së paku një vit.”.

Në paragrafin (4) fjalët: “ose gjatë sigurimit u përcaktohet stazh i sigurimit me kohëzgjatje të zmadhuar,” shlyhen.

Neni 3

Në nenin 159 paragrafi (5) fjalët: “Qeveria e Republikës së Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Këshilli drejtues”.

Neni 4

Në nenin 164-a paragrafi (1) alineja 3 fjalët: “ udhëheqës i seksionit – informatikë“ dhe presja shlyhen, ndërsa presja pas fjalës “specialist” dhe fjalët: “informatikan grupi I “ shlyhen.

Në alinenë 4 fjalët: “informatikan nga grupi II” zëvendësohen me fjalët: “udhëheqës i seksionit – informatikë”.

Në alinenë 5 fjalët “ informatikan nga grupi III” zëvendësohen me fjalët: “ndihmës i udhëheqësit të seksionit – informatikë “.

Në alinenë 7 para fjalës: “udhëheqës” shtohen fjalët: “ informatikan nga grupi I, “.

Në alinenë 8 para fjalës “brendshëm” shtohen fjalët: “ informatikan nga grupi II,“.

Neni 5

Në nenin 164-b paragrafi (4) pas fjalëve: “Ligji për nëpunës administrative” shtohen fjalët: “dhe marrëveshje kolektive”.

Neni 6

Në nenin 187 paragrafi (1) pika 7) ndryshohet si vijon:

„ pjesë e shumës së akcizës së paguar të energjentëve nga neni 92 paragrafi (3) pikat 1), 2) dhe 5) të Ligjit për akciza.“.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, ndërsa dispozitat e nenit 6 të këtij ligji me të cilat në nenin 187 paragrafi (1) ndryshohet pika 7 do të fillojnë të zbatohen nga 1 nëntori 2019.